Kronikë

# Policia patrullim në Kiras/ Thirrje një automjeti të ndalojë, shoferi tenton të largohet, por prangoset! Pasagjeri qëllon me armë në ajër dhe arratiset

*Patrulla i ka kërkuar një automjeti të ndalojë, ndërsa shoferi, i cili shoqërohej na një tjetër person, nuk i është bindur urdhrit, ka shtuar shpejtësinë dhe është larguar. Policia po vijon me kontrollet e imtësishme në lagjen e Kirasit, zonë që njihet si bastion i grupit të Ibrahim Licit.*

Redaksia
9 Mars, 16:15 | **Përditesimi: 9 Mars, 22:08**

Share Post

Të shtëna me armë zjarri raportohen gjatë një patrullimi rutinë rreth orës 15:10 në lagjen "Guerrile" apo "Kiras" në Shkodër, e njohur ndryshe si bastion i grupit të Ibrahim Licit. Policia i ka bërë shenjë ndalimi një automjeti që po lëvizninë 2 persona, me qëllim kryerjen e kontrollit.

Megjithatë, drejtuesi i makinës nuk i është bindur urdhrit të policisë, ka shtuar shpejtësinë e makinës dhe ka kryer manovra të rrezikshme. Kaq ka mjaftuar që bluté t'i vihen në ndjekje, kohë në të cilën pasagjeri në këtë makinë, duke u larguar, ka qëlluar një herë në ajër me armë zjarri dhe është larguar.

Policia ka mundur të kap drejtuesin e automjetit, për të cilin policia nuk bën publik inicialet prej konfidencialitetit të hetimit. Dyshohet se personi në fjalë është me rrezikshmëri të lartë dhe i shpallur më herët në kërkim nga policia. Dhjetëra forca policia kanë mbërritur në vendndjarje duke rrethuar zonën ndërsa vijon operacioni duke bllinduar me efektivë dhe masa të rrepta sigurie.

> *"Shkodër/Informacion paraprak*
>
> *Rreth orës 15:10, gjatë patrullimit në lagjen "Guerrile", shërbimet e Policisë i kanë bërë shenjë ndalimi, një automjeti me të cilin lëvizninë 2 shtetas, me qëllim kryerjen e kontrolleve. Drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë, por ka shtuar shpejtësinë e lëvizjes dhe ka kryer manovra të rrezikshme me automjet.*
>
> *Për këto arsye, shërbimet e Policisë i janë vënë në ndjekje automjetit. Gjatë ndjekjes, dyshohet se pasagjeri në këtë automjet, duke u larguar ka qëlluar një herë, në ajër, me armë zjarri, dhe është larguar.*
>
> *Shërbimet e Policisë kanë kapur drejtuesin e automjetit, inicialet e të cilit nuk bëhen të ditura për momentin, për shkak të konfidencialitetit të hetimit.*
>
> *Ndërkaq, vijon intensivisht puna për lokalizimin dhe kapjen e pasagjerit në këtë automjet.*
>
> *Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po punon për të zbardhur rrethanat e rastit", thuhet në njoftimin e policisë.*

K.B/Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër

Komento

## Komente

dobrac: 09/03/2026 22:00

u ka ik prap ai vrasesi me pages nga vlora gentjano mehmeti polici e koruptume

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**PS nuk jep aprovimin për arrestimin e Ballukut, si e vlerësoni?**
9 Mars, 15:01

Të drejtë | Të gabuar | Jam i/e dyzuar

## Lajme të tjera

**Moti i ngrohtë rikthen vizitorët në bregdetin e Shëngjinit, në Velipojë bizneset angazhohen për pastrimin e hapësirave**

Elvis Hila

8 Mars, 13:33

**7 Marsi/ Mësuesi i njohur i Shkodrës: Sot u jepet rëndësi godinave, jo përmbajtjes! S'kemi teknikë për HEC-et**

Ergys Kavaja

7 Mars, 15:46

**Banorët e Rrjollit 37 ditë protestë kundër ndërtimit të resortit të Bashkim Ulajt: S'i lëshojmë tokat tona, të ndalohen punimet deri sa të 'flasë' gjykata**

Ergys Kavaja

7 Mars, 15:39

**Kur oligarkia e shkruan vetë ligjin, Rrjolli dhe e vërteta lakuriqe e propagandës**

Kristjan Zoto

7 Mars, 11:14

**Protestat në Rrjoll/ Prek Molla: Policia po paguhet për të mbrojtur oligarkun Ulaj! Balliu: E patolerueshme dhuna e përdorur ndaj banorëve**

6 Mars, 19:13

**Gjyqi ndaj kryebashkiakut të Vaut të Dejës për korrupsion zgjedhor, zbardhen dëshmitë në GJKKO: Tom Doshi më ka ndihmuar kur kisha burrin sëmurë, detyrim moral për ta votuar**

Keti Banushi

6 Mars, 15:42

**Degradon konflikti për pronën në Rrjoll/ Fatmir Shpellzaj pretendon se i kanë dhunuar djalin, banorët e mohojnë: I shkuam për t'i marrë dokumentet, na doli me 15 vetë**

6 Mars, 10:56

**Të shtëna me armë zjarri në Shkodër, plagoset një person! Policia arreston autorin (EMRAT+VIDEO)**

5 Mars, 21:42

**Marrëveshja me KFW për investime të reja në ujësjellës për Shkodrën, Lezhën dhe Sarandën, Malaj: Mbi gjysma e popullsisë urbane do të ketë furnizim më të sigurt me ujë**

5 Mars, 19:16

**Akuzojnë Bashkim Ulajn se po u grabit pronat për të ndërtuar resort, banorët e Rrjollit protestojnë para Kuvendit**

5 Mars, 18:29

**Nuk zbatoi vendimin e Gjykatës për rikthimin në detyrë të drejtorit të Ujësjellësit Shkodër, SPAK kërkon dënim me 700 mijë lekë gjobë për Bardh Spahinë**

Keti Banushi

5 Mars, 14:18

**U arrestuan pas përplasjes me punonjësit e 'Breçani Security', Gjykata e Shkodrës liron 8 banorët e Rrjollit, por i ndalon të protestojnë**

5 Mars, 12:40

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje